



Organizata për  
Demokraci, Antikorrupsion  
dhe Dinjitet, Çohu!



Pro Open  
Koalicioni për Hajje të  
te Dhenave dhe Llogandhënie  
në Prokurim Publik

# Keqpërdorimi në Prokurim Publik





# **Keqpërdorimi në Prokurim Publik**

Ky hulumtim është realizuar në Kuadër të  
Koalicionit për Hapje të të Dhënave dhe  
Llogaridhënie në Prokurim Publik, mbështetur nga  
Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur.



**Deklaratë mohimi:**

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi  
vetëm e organizatës Çohu! dhe në asnjë  
mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i  
pikëpamjeve të donatorit

**Përpiluar nga:**

Rina Koliqi

**Monitorues:**

Drilon Dobruna, Artan Sufaj, Lirie Aliu

**Lekturoi:**

Besa Kalaja

**Layout & Design**

envinion

Origjinali është shkruar në shqip

**Publikuar nga:**

Organizata për Demokraci,  
Antikorrupsion dhe Dinjitet, Çohu!

Rruga: UÇK 25-1

Prishtinë, Kosovë

Tel / +383 (0)38 248 506

[www.cohu.org](http://www.cohu.org)

# Përmbajtja

SHKURTESAT .....	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	8
HYRJE .....	9
1. RREGULLIMI I KORRUPSIONIT NË PROKURIM PUBLIK NË KODIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS .....	10
2. ZBATIMI I DISPOZITËS 415 SI DHE RASTET PRAKTIKE TË KEQPËRDORIMEVE NË PROKURIM PUBLIK.....	11
3. PROFILIZIMI DHE TRAJNIMET E PROKURORËVE NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK .....	14
4. SFIDAT DHE PROBLEMET .....	15
PËRFUNDIME .....	16
REKOMANDIME .....	17



# Lista e shkurtesave

**Çohu!** Organizata për Demokraci, Anti-Korrupsion dhe Dinjitet

**KGJK** Këshilli Gjyqësor i Kosovës

**KPK** Këshilli Prokurorial i Kosovës

**AD** Akademia e Drejtësisë

**KPRK** Kodi Penal i Republikës së Kosovës



Propozimi i Organizatës Çohu! që në Kodin e ri Penal të jetë vepra e veçantë që ka të bëjë me keqpërdorim dhe mashtrim në prokurim publik, ishte aprovuar nga grupi punues për ndryshim dhe plotësim të Kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe vepra penale “Keqpërdorimi dhe mashtrimi në Prokurim Publik” tashmë neni 415 i KPRK-së ka hyrë në fuqi ne muajin prill të vitit 2019.

# Përmbledhje ekzekutive

Organizata për Demokraci dhe Anti-Korrupsion, dhe Dinjtet (tutje në tekst Organizata Çohu!), gjatë procesit për ndryshim dhe plotësim të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, kishte propozuar amendamentin që në Kodin e ri Penal të jetë vepra penale e veçantë që ka të bëjë me keqpërdorim dhe mashtrim në prokurim publik, propozimi tillë ishte aprovuar nga grupi punues dhe vepra penale: *“Keqpërdorim dhe mashtrim në prokurimin publik”* tashmë neni 415 të KPRK-së ka hyrë në fuqi në muajin prill të vitit 2019.

Mëqenëse prokurimi publik vazhdon të mbetet një ndër shtyllat më të rëndësishme në proceset publike të shpenzimit të parasë publike, Organizata Çohu! gjatë periudhës njëvjeçare të monitorimit në gjykatat themelore ka trajtuar me prioritet monitorimin e rasteve të tilla të keqpërdorimit dhe mashtrimit në prokurim publik nga zyrtarët dhe institucionet e ndryshme të vendit.

Gjatë monitorimit Çohu! ka identifikuar 34 raste në gjykatat themelore Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Gjakovë dhe Gjiilan, në të cilat dyshohet se procedurat tenderuese nuk kanë shkuar sipas dispozitave ligjore. Mosrespektimi i procedurave ligjore gjatë procedurave tenderuese dhe shkelja e ligjeve relevante kishte rezultuar me keqpërdorimin e parasë publike nga institucionet dhe nga zyrtarë të shumtë.

Inkorporimi i dispozitës së tillë, është vlerësuar si i suksesshëm edhe nga vet akterët e sistemit të drejtësisë, në veçanti nga sistemi prokurorial. Të njëjtit vlerësojnë se inkorporimi i dispozitës së re 415 të KPRK-së, është hap i rëndësishëm në fushën e drejtësisë megjithatë prokurimi publik në përgjithësi si dhe dispozita e re në veçanti konsiderohet si fushë komplekse andaj dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës planifikon një qasje të re në raport me këtë vepër.<sup>1</sup>

Me qëllim të ngritjes profesionale të prokurorëve dhe gjykatësve në fushën e prokurimit publik, Akademia e Drejtësisë në Kosovë ka mbajtur 5 ditë trajnime të specializuara me përafërsisht 30 gjyqtarë dhe 10 prokurorë.

Megjithatë sfidë e vazhdueshme e sistemit të drejtësisë mbetet profilizimi i prokurorëve në fushën e prokurimit publik.

Duke pasur parasysh faktin se prokurimi është një ndër mundësitë e keqpërdorimit të parasë publike nga zyrtarë dhe institucione të shumta që përfshinë shumë aktivitete procedurale dhe financiare, e gjithashtu një mundësi e përfitimit të jashtëligjshëm për shumë zyrtarë, trajtimi i lëndëve të prokurimit konsiderohet më kompleks dhe kërkon një trajtim profesional. Përkundër kësaj lëndët e kësaj natyre vazhdojnë të trajtohen sikur lëndët e tjera të korrupsionit, shumë prej të cilave edhe kishin dështuar qysh në fazat e para procedurale për shkak të defekteve profesionale të prokurorisë në veçanti.

Sfidë tjetër është mungesa e ekspertëve të specializuar në fushën e prokurimit, të cilët me ekspertizat e tyre profesionale do të ndihmonin punën e prokurorive themelore.

Duke u bazuar në gjetjet e hulumtimit dhe analizën e të dhënave janë dhënë rekomandime me theks të veçantë në uljen e korrupsionit në prokurim publik, duke vënë në pah gjetjet kryesore dhe adresimin e tyre për institucionet relevante të zbatimit të ligjit.

1 Shënim: Intervistë me kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës z. Bahri Hyseni, 11 shkurt 2020, Prishtinë



# Hyrje

Prokurimi publik paraqet një proces tejet të rëndësishëm përmes së cilit qeveria dhe institucionet tjera publike, kryejnë procedura të ndryshme tenderuese (blerja e mallrave dhe shërbimeve), vlerat e të cilave zakonisht përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të GDP-së.

Për shkak të natyrës kontraktuale të prokurimit publik me akterë ekonomikë nga sfera private, shpeshherë ky proces është parë si një vegël për keqpërdorimin e mjeteve publike, korrupsionit dhe ndikimit jo të barabartë ndërmjet akterëve ekonomikë dhe zbatuesve qeveritarë të prokurimit publik.<sup>2</sup>

Duke pasur parasysh se prokurimi publik është nxitës me rëndësi në zhvillimin ekonomik të vendit, një hap të rëndësishëm drejt luftës kundër korrupsionit në fushën e prokurimit është bërë me nismën e saj për kategorizimin e veprës penale e cila lidhet direkt me keqpërdorimet dhe mashtrimet të cilat ndodhin në prokurim publik në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, vepër kjo e cila pas ndryshimeve dhe plotësimit të KPRK-së ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2019.

Organizata Çohu! gjatë monitorimit njëvjeçar ka pasur me prioritet monitorimin e rasteve të korrupsionit të cilat ndërlidhen me mosrespektim të procedurave të prokurimit, konkretisht me shkelje të ligjit të prokurimit si dhe zbatimin e dispozitës 415 të KPRK-së. Në bazë të të dhënave të monitorimit, Organizata Çohu! gjatë periudhës njëvjeçare të monitorimit ka identifikuar **34 raste të cilat kanë të bëjnë me keqpërdorime në prokurim publik.**

Sidoqoftë, bazuar në gjetjet e Organizatës Çohu!, prokuroritë dhe gjykatat vazhdojnë të përballen me vështirësi në trajtimin e lëndëve të prokurimit publik për shkak të natyrës komplekse të tyre, vështirësi këto që vazhdojnë të shkaktojnë probleme në mbarëvajtjen e proceseve dhe mungesën e rezultateve.

**ORGANIZATA ÇOHU!  
GJATË PERIUDHËS  
NJËVJEÇARE TË  
MONITORIMIT KA  
IDENTIFIKUAR 34  
RASTE TË CILAT  
KANË TË BËJNË ME  
KEQPËRDORIME NË  
PROKURIM PUBLIK.**

<sup>2</sup> Tenderomania e (pa)ndëshkuar, prill 2018, Organizata për Demokraci dhe Anti-Korrupsion, Çohu!: [http://www.cohu.org/repository/docs/01 - Tenderomania\\_ne\\_Ndjekje - 05\\_252314\\_137170.pdf](http://www.cohu.org/repository/docs/01 - Tenderomania_ne_Ndjekje - 05_252314_137170.pdf)

# 1. Rregullimi i korrupsionit në prokurim publik në Kodin e Republikës së Kosovës

Në Republikën e Kosovës vazhdon të mbetet shqetësim natyra endemike e korrupsionit në shumë fusha të jetës publike dhe private përfshirë këtu dhe prokurimin publik.

Duke pasur parasysh mosrespektimin e dispozitave ligjore gjatë procedurave tenderuese dhe shkeljen e ligjeve, Organizata Çohu! gjatë punimeve për ndryshim dhe plotësim të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, mbështetur nga organizata të tjera të shoqërisë civile, kishte propozuar që në kuadër të kapitullit të korrupsionit të hyjë vepra penale e cila ndërlihet me rastet e prokurimit publik.

Grupi punues për ndryshim dhe plotësim të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh një realitet ekzistues, rreziqet e korrupsionit në prokurim publik e gjithashtu efikasitetin në luftimin e kësaj dukurie kishte aprovuar propozimin e tillë, reformë e rëndësishme kjo e cila ka për qëllim uljen e dukurisë së korrupsionit në fushën e prokurimit publik.

Si rrjedhojë e kësaj, vepra penale “Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik”, ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2019.

Neni 415 i KPRK-së, parasheh dënime për personat që shkelin rregullat e prokurimit publik gjatë një oferte për dhënien e kontratës së prokurimit publik apo ndërmerr ndonjë veprim tjetër të paligjshëm me qëllim të mashtrimit në procedurat e prokurimit publik dhe më qëllim të ndikimit në vendimin e një autoriteti kontraktues në procedurën e prokurimit publik si dhe ndaj personave të cilët qëllimisht shkelin procedurat e prokurimit më qëllim të përfitimit për vete apo duke shkaktuar dëme buxhetore.<sup>3</sup>

---

<sup>3</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 415: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

## 2. Zbatimi i dispozitës 415 si dhe rastet praktike të keqpërdorimeve në prokurim publik

Organizata Çohu! gjatë monitorimit të seancave gjyqësore, në gjykatat themelore në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Ferizaj, Gjilan, Gjakovë dhe Prizren, ka identifikuar raste të korrupsionit të cilat ndërlidhen me shkelje të ligjit të prokurimit publik dhe shkeljen e procedurave tenderuese në fushën e prokurimit publik.

Në bazë të të dhënave të cilat i ka siguruar Çohu! nga Këshilli Prokurorial i Republikës së Kosovës gjatë vitit 2019 në prokuroritë themelore në Prishtinë, Prizren dhe Gjakovë, rezulton se për veprat penale të cilat




ndërlidhen me prokurim publik, ndaj 27 personave janë zgjidhur kallëzimet penale, ku ndaj 13 personave është hedhur kallëzimi penal, për 6 persona është pushuar hetimi ndërsa ndaj 8 personave është ngritur aktakuzë pas fillimit të hetimeve.<sup>4</sup>

Në tabelën numër 1 janë të pasqyruara numrat e personave ndaj të cilëve janë ndërmarrë veprime procedurale në prokuroritë themelore në Prizren, Prishtinë dhe Gjakovë, për vitin 2019.

---

<sup>4</sup> Shënim: Organizata Çohu!, përmes email-it më datë 21 janar 2020 ka pranuar përgjigje nga KPK rreth mënyrës së zgjidhjes së rasteve të cilat ndërlidhen me prokurim publik.



	Gjithsej persona të përfshirë në kallëzime penale	Hedhje të kallëzimit penal	Pushuar hetimi	Aktakuza pas zhvillimit të hetimit
 PTh Prizren	<b>13</b>	2	4	7
				
 PTh Prishtinë	<b>12</b>	11	-	1
				
 PTh Gjakovë	<b>2</b>	-	2	-
				
<b>Gjithsej persona</b>	<b>27</b>	<b>13</b>	<b>6</b>	<b>8</b>

**Tabela numër 1.** Mënyra e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit të cilat ndërlidhen me Prokurim Publik në Prokuroritë Themelore të Republikës së Kosovës, për vitin 2019

Megjithatë sistemi i drejtësisë në Republikën e Kosovës është ballafaquar vazhdimisht me një numër të konsiderueshëm të lëndëve të korrupsionit e të cilat ndërlidhen më keqpërdorime të ndryshme gjatë procedurave të tenderimit apo prokurimit publik.

Duke u bazuar në të dhënat e monitorimit, gjatë periudhës njëvjeçare shkurt 2019 – janar 2020, në gjykatat e Republikës së Kosovës janë identifikuar 34 raste të korrupsionit e të cilat përmbajnë shkelje të ligjit të prokurimit publik (bazuar në Kodin Penal i cili ishte në fuqi deri në muajin prill të vitit 2019).

<b>Gjykata</b>	<b>Nr. i lëndës</b>	<b>Vepra penale</b>	<b>Vendimet</b>
1. Mitrovicë	P.nr.156/17	Neni 422	<b>Aktgjykim lirues</b>
2. Mitrovicë	P.nr. 117/18	Neni 422	-
3. Prishtinë	Pkr.nr 369/16	Neni 422	<b>Rigjykim</b>
4. Prishtinë	Pkr.nr. 886/13	Neni 422	<b>Aktgj. refuzues dhe lirues</b>
5. Prishtinë	Pkr.nr.734/15	Neni 422	<b>Aktgjykim lirues</b>
6. Prishtinë	Pkr.nr. 204/18	Neni 422	<b>Aktgjykim lirues</b>
7. Prishtinë	Pkr.nr. 148/18	Neni 422	-
8. Prishtinë	Pkr.nr. 166/17	Neni 422	-
9. Prishtinë	Pkr.nr. 220/17	Neni 422	<b>Rigjykim</b>
10. Prishtinë	Pkr.nr. 359/17	Neni 422	-
11. Prishtinë	Pkr.nr. 192/17	Neni 422	<b>Aktgjykim lirues</b>
12. Prishtinë	Pkr.nr. 12/17	Neni 423	-
13. Prishtinë	Pkr.nr. 16/18	Neni 422,398	-
14. Prishtinë	Pkr.nr. 519/17	Neni 422	-
15. Prishtinë	Pkr.nr. 185/18	Neni 422	-
16. Prishtinë	Pkr.nr. 145/19	Neni 422	-
17. Prishtinë	Pkr.nr. 110/17	Neni 424	<b>Dënim me gjobë</b>
18. Prishtinë	Pkr.nr. 53/17	Neni 422	<b>Dënim me burgim ose me gjobë</b>
19. Prishtinë	Pkr.nr. 60/19	Neni 422	<b>Dënim me kusht</b>



Gjykata	Nr. i lëndës	Vepra penale	Vendimet
20. Gjakovë	Pkr.nr. 36/18	Neni 422, 434,285	<b>Dënim me kusht</b>
21. Prizren	Pkr.nr. 87/18	Neni 422	-
22. Pejë	Pkr.nr. 28/18	Neni 424	-
23. Pejë	Pkr.nr. 75/18	Neni 422	-
24. Gjakovë	Pkr.nr. 14/19	Neni 422	-
25. Pejë	Pkr.nr. 227/16	Neni 274,339 KPPK	-
26. Prizren	Pkr.nr. 37/19	Neni 422	-
27. Prizren	Pkr.nr. 42/19	Neni 422, 424	-
28. Pejë	Pkr.nr. 41/19	Neni 422	-
29. Prizren	Pkr.nr. 53/19	Neni 422	-
30. Prizren	Pkr.nr. 54/19	Neni 422	-
31. Prizren	Pkr.nr. 57/19	Neni 422	-
32. Prizren	Pkr.nr. 111/19	Neni 422	-
33. Gjiilan	Pkr.nr. 78/19	Neni 422	<b>Rigjykim</b>
34. Gjiilan	Pkr.nr. 145/17	Neni 422	<b>Aktgjykim refuzues</b>

**Tabela 2.** Veprat penale të korrupsionit të ndërlidhura me shkelje të ligjit të prokurimit publik

Nga të dhënat e monitorimit të cilat janë të pasqyruara në tabelën numër 2, vërehet se niveli i ndeshkueshmërisë së zyrtarëve të cilët kanë shkelur ligjin e prokurimit është i ulët. Nga të dhënat e njëjta, vërehet se në gjykatat themelore Mitrovicë, Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë janë shpallur kryesisht vendime liruese dhe

refuzuese ndërsa në raste më të rralla janë shqiptuar dënime me kusht, dënime me gjobë dhe në fund dënime me burgim, tutje shumë raste të korrupsionit të cilat kanë të bëjnë me mosrespektim të procedurave të tenderimit vazhdojnë të jenë në proces të shqyrtimit gjyqësor.

# 3. Profilizimi dhe trajnimet e prokurorëve në fushën e prokurimit publik

Veprat penale të cilat rrjedhin nga korrupsioni në prokurim publik, konkretisht veprimet të cilat kanë qëllim shkeljen e qëllimshme të procedurave tenderuese tashmë janë të rregulluara dhe kategorizuara me nenin 415 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Duke pasur parasysh natyrën komplekse të lëndëve të prokurimit publik, kjo çështje kërkon një trajtim më të veçantë. Andaj, një rëndësi të madhe në këtë drejtim kanë trajnimet profesionale të prokurorëve në fushën e prokurimit publik si dhe profilizimi i tyre me qëllim që keqpërdorimet të cilat ndodhin në prokurim publik të trajtohen me prioritet, për shkak të dëmit të madh që po i shkaktohet buxhetit të Republikës së Kosovës gjatë procedurave të prokurimit publik.

Programi i trajnimeve të prokurimit publik në Akademinë e Drejtësisë kishte filluar në vitin 2015, nga ajo kohë deri tani janë mbajtur 13 ditë apo 26 sesione trajnime në fushën e prokurimit publik. Vetëm gjatë vitit 2019 AD ka mbajtur 5 ditë trajnime të specializuara në fushën e prokurimit publik, e gjithë kjo me qëllim të avancimit të njohurive të gjykatësve dhe prokurorëve. Pjesë e këtyre trajnimeve në fushën e prokurimit publik, kanë qenë rreth 30 gjykatës dhe 10 prokurorë.<sup>5</sup>

Në planin vjetor të vitit 2020 ndër të tjera, Akademia e Drejtësisë ka paraparë mbajtjen e trajnimeve të specializuara në fushën e prokurimit publik për bashkëpunëtorë profesionalë si dhe zyrtarë ligjorë të cilët me punën e tyre do të kontribuojnë në zgjidhjen efikase dhe efektive të lëndëve të kësaj natyre.<sup>6</sup>

Në këtë drejtim mungesës së efikasitetit dhe efektivitetit në luftën kundër korrupsionit në prokurim publik në Kosovë përveç të tjerave në masë të madhe vazhdon t'i kontribuojë mungesa e prokurorëve të profilizuar dhe mungesa e ekspertëve të specializuar në prokurim publik.

Ngritja e kapaciteteve profesionale të prokurorëve apo edhe profilizimi i tyre në fushën e prokurimit publik do të kishte ndikim trajtimin e rasteve më me profesionalizëm dhe efikasitet, do të ndihmonte në zbardhjen e rasteve të shumta të cilat mbesin në fazën e dyshimeve dhe gjithashtu si përfundim do t'i ndihmonte sistemit prokurorial në rezultate më të mira dhe në zvogëlimin e dukurisë së tillë.

<sup>5</sup> Shënim: Intervistë me Drejtorin e Akademisë së Drejtësisë z. Enver Fejzullahu, 20 shkurt 2020, Prishtinë

<sup>6</sup> Ibid.



# 4. Sfidat dhe problemet

Trajtimi i fushës së prokurimi publik në përgjithësi dhe implementimi i dispozitës së re 415 të KPRK-së e cila ka të bëjë me keqpërdorim dhe mashtrim në prokurim publik në veçanti ballafaqohet me vështirësi të ndryshme për shkak të natyrës komplekse dhe të ndërlikuar të kësaj fushe.

Me gjithë sfidat dhe vështirësitë që përcillet implementimi i dispozitës së re për shkak të kompleksitetit të saj, zyrtarë të lartë të KGJK-së e vlerësojnë inkorporimin e kësaj vepre si një hap shumë të rëndësishëm i cili do t'ua lehtësojë punën e gjyqtarëve rreth trajtimit të këtyre rasteve, sidomos rreth vlerësimit të elementeve që e përbëjnë figurën e kësaj vepre, gjë e cila ndikon pozitivisht në shqyrtimin e këtyre lëndëve në të gjitha fazat e procedurës dhe zgjidhjen përfundimtare të tyre. Njëkohësisht duke ndikuar në rritjen e efikasitetit, rritjen e besimit të qytetarëve në sistemin gjyqësor të Kosovës, pasi që do të reduktoheshin në masë të madhe rastet e tilla në shoqërinë tonë në përgjithësi.<sup>7</sup>

Bazuar në të dhënat e hulumtimit të Organizatës Çohu!, sfidë e cila e kategorizon sistemin tonë të drejtësisë vazhdon të jetë numri i vogël i gjykatësve dhe prokurorëve të cilët marrin pjesë në trajnimet e Akademisë së Drejtësisë, të cilat ndihmojnë në ngritjen e kapaciteteve për trajtimin e rasteve të keqpërdorimeve në prokurim publik.

Duke u bazuar në të dhënat e njëjta, sfidë e sistemit të drejtësisë paraqet dhe mungesa e ekspertëve profesionalë të cilët me punën e tyre ndihmojnë në lidhje me zgjidhjen efikase dhe efektive të lëndëve gjyqësore të kësaj natyre.

Në prokuroritë themelore të Kosovës është vetëm një (1) ekspert i cili është i specializuar në fushën e prokurimit publik, megjithatë KPK synon që në të ardhmen të angazhojë ekspertë të tjerë të cilët do t'iu ndihmojnë prokurorëve që më lehtë të vijnë deri tek grumbullimi i fakteve dhe të provave të cilat do ta dëshmonin një mashtrim në prokurim publik.<sup>8</sup>

Sfidë tjetër mbetet mungesa profesionale të prokurorëve dhe mungesa të profilizimit të tyre në fushën e prokurimit publik.

Me qëllim të evitimit të sfidave të zbatimit të dispozitës së re 415 të KPRK-së, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka planifikuar një angazhim më të madh në këtë drejtim, përfshirë këtu profilizimin e prokurorëve si dhe krijimin e një praktike e cila do të ndihmojë në hetimin dhe ndjekjen e kryesve të këtyre veprave penale.<sup>9</sup>

Ndërsa, sfida me të cilën po ballafaqohet Akademia e Drejtësisë në këtë drejtim ka të bëjë me praktikën ligjore pasi që këtij institucioni i duhet një kohë më e gjatë që risitë e legjislacionit të cilat bëhen nga organet kompetente t'i shndërrojë roj në një praktikë të mirë.<sup>10</sup>

7 Shënim: Intervistë përmes email-it me Kryesuesin e KGJK-së z. Skender Çoçaj, 9 mars 2020, Prishtinë.

8 Shënim: Intervistë me kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës z. Bahri Hyseni, 11 shkurt 2020, Prishtinë

9 Ibid

10 Shënim: Intervistë me Drejtorin e Akademisë së Drejtësisë z. Enver Fejzullahu, 20 shkurt 2020, Prishtinë



# Përfundime

Bazuar në hulumtimin e Organizatës Çohu!, ndonëse janë ndërmarrë disa hapa për lehtësimin e luftës kundër korrupsionit në prokurim publik, duke filluar nga kodifikimi i veprës penale e cila ndihmon në punën e Prokurorisë në luftimin dhe identifikimin e veprave që lidhen me prokurim publik, ngritja e shkathtësive profesionale përmes trajnimeve të reja e deri tek trajtimi me prioritet i rasteve të tilla.

Sistemi i drejtësisë në Republikën e Kosovës vazhdon të ballafaqohet me probleme të shumta të cilat shpien në mungesë të efikasitetit në luftimin dhe ndëshkimin e këtij lloji të krimit.

Mungesa profesionale e prokurorëve si dhe profilizimi i tyre vazhdojnë të mbeten një ndër problemet më të mëdha të sistemit të drejtësisë, probleme këto të cilat rezultojnë me mungesë të efikasitetit dhe efektivitetit në luftën kundër korrupsionit në prokurim publik në Kosovë.

Mos-profilizimi i prokurorëve paraqet vështirësi në trajtimin e lëndëve të korrupsionit të cilat janë të ndërlikura me prokurim publik, duke pasur parasysh natyrën e ndërlikuar dhe komplekse të këtyre lëndëve. Po ashtu, numri i vogël i gjykatësve dhe prokurorëve të cilët kanë marrë pjesë në trajnimet e mbajtura nga AD në fushën e prokurimit publik, paraqet një shqetësim tjetër i cili në praktikë mund të rezultojë në mungesë të efikasitetit dhe efektivitetit në zgjidhjen e lëndëve të kësaj natyre nga organet kompetente.

Mungesa e ekspertëve të specializuar në prokurim publik po ashtu paraqet vështirësi në lidhje me zgjidhjen efikase dhe efektive të lëndëve e të kësaj natyre, për shkak se përmes ekspertizave të kësaj natyre, organet kompetente arrijnë të bëjnë ndriçimin dhe sqarimin e fakteve kontestuese.

Organizata Çohu! duke u bazuar në të dhënat e monitorimit njëvjeçar të rasteve të korrupsionit të cilat përfshijnë shkelje të ligjit të prokurimit publik, konsideron shqetësuese dënimet e ulëta dhe lirimin e zyrtarëve nga gjykatat themelore për rastet e korrupsionit e të cilat përfshijnë shkelje të ligjit të prokurimit.



# Rekomandime

Të organizohen trajnime periodike në Akademinë e Drejtësisë, në fushën e prokurimit publik për gjykatës dhe prokurorë;

Të rritet numri i ekspertëve të specializuar në fushën e prokurimit publik në prokuroritë themelore;

Të organizohen trajnime periodike në Akademinë e Drejtësisë, në fushën e prokurimit publik për bashkëpunëtorë profesionalë;

Të bëhet kategorizimi i të dhënave për veprën penale të re e cila ka të bëjë me keqpërdorim dhe mashtrim në prokurim publik;

Të rritet numri i gjykatësve dhe prokurorëve të cilët marrin pjesë në trajnimet të cilat mbahen nga Akademia e Drejtësisë në fushën e prokurimit publik;

Të evidentohen dhe eliminohen sfidat dhe problemet të cilat paraqiten në praktikë me rastin e implementimit të dispozitës së re 415 të KPRK-së;

Të ngritën kapacitetet profesionale për trajtimin e lëndëve të prokurimit publik nga ana e KPK-së;

Të garantohet një proces i mirëfillt gjyqësor për qytetarët, brenda të cilit respektohen të drejtat e njeriut ndër këto e drejta për gjykim të drejtë dhe brenda kohës së arsyeshme.

Të bëhet profilizimi i prokurorëve në fushën e prokurimit publik;



